

Ku paraqitet kërkesa?

Gjykata vihet në lëvizje me anë të kërkesës, e cila mund të paraqitet dorazi ose me postë në adresën: Rruga “Jordan Misja”, Nr. 1 Tiranë.

Individi i cili dëshiron të paraqesë kërkesën dorazi, mund të paraqitet pranë Gjykatës, në KryeSekretari dhe të Dokumentacionit, çdo ditë pune, nga ora 08.00-16.00. Në rast të dërgimit të kërkesës me postë, data e paraqitjes së saj konsiderohet data e dorëzimit në zyrën postare. Në rast se kërkesa është dërguar gabimisht në një institucion tjetër dhe kërkesa është paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar pas përfundimit të afatit ligjor, kërkesa konsiderohet e paraqitur në afat në rast se provohet se kjo ka ndodhur në mirëbesim.

Ligji nuk parashikon paraqitjen e kërkesës në formë elektronike apo me fax.

A ka një model për hartimin e kërkesës në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar? Nëse po, ku mund ta gjej atë?

Në faqen zyrtare të Gjykatës e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar www.gjp.gov.al gjendet formulari i paraqitjes së kërkesës, si dhe këshilla praktike për plotësimin e tij, të cilat, gjithashtu, kanë karakter orientues dhe jo detyrues. Kërkuesi mund të paraqitet edhe pranë Gjykatës e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të tërhequr një model të Formularit, por administrata e Gjykatës nuk mund ta ndihmojë në plotësimin e tij.